

Anëtarët e KBR-së

Shqipëria*
 Austria*
 Bosnja dhe Hercegovina*
 Bulgaria*
 Kanadaja
 Këshilli i Evropës
 Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës
 Kroacia*Republika Çeke*
 Danimarka
 Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
 Banka Investuese Evropiane
 Bashkimi Europian (BE), i përfaqësuar nga një përfaqësues i Përfaqësueses së Lartë të BE për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe një përfaqësues i Komisionit Europian*
 Republika Federale e Gjermanisë*
 Finlanda*
 Franca*
 Greqia*
 Hungaria*
 Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
 Irlanda*
 Italia*
 Letonia*
 Moldavia*
 Mali i Zi*
 Organizata e Traktatit Veri Atlantik
 Norvegjia*
 Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
 Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
 Polonia
 Rumania*
 Serbia*
 Sllovakia
 Sllovenia*
 Iniciativa e Bashkëpunimit për Evropën Juglindore
 Spanja*
 Suedia*
 Zvicra*
 Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë*
 Turqia*
 Mbretëria e Bashkuar
 Organizata e Kombeve të Bashkuara
 Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
 Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
 Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në emër të Kosovës në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara*
 Shtetet e Bashkuara të Amerikës*
 Banka Botërore

*anëtarë të Bordit të KBR-së

MISIONI YNË
 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal promovon bashkëpunimin reciprok dhe integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik të Evropës Juglindore për të frymëzuar zhvillimin e rajonit për të mirën e popullit të saj.



Regional Cooperation Council

Sekretariati i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal

Sheshi Bosnje dhe Hercegovinë 1/V
 71000 Sarajevë
 Bosnjë dhe Hercegovinë
 Tel: +387 33 561 700
 Faks: +387 33 561 701
 Posta elektronike: rcc@rcc.int

www.rcc.int
 twitter.com/rccint

SQ

güneydoğu avrupa'da işbirliği, bölgenin avrupa ve avrupa-atlantik bölgesi ile entegrasyonu



Bashkëpunimi, Integrimi Evropian dhe Euro-Atlantik i Evropës Juglindore

“Ndihma për prosperitetin dhe rritjen nëpërmjet veprimit rajonal në Evropën Juglindore dhe duke mbështetur integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik, është ajo që Këshilli për Bashkëpunim Rajonal është mbi të gjitha. Ne e shohim rajonin tonë si një vend të dialogut, lirisë dhe lëvizshmërisë, të pasur në trashëgiminë kulturore, ku çdo njeri ndihet i sigurt dhe i mbrojtur nga sundimi i ligjit. Puna jonë pasqyron gatishmërinë dhe afësinë e popullit të Evropës Juglindore për të marrë përgjegjësinë për të ardhmen e tyre, dhe për të krijuar kushtet për një përparim të përgjithshëm në një klimë të tolerancës dhe bashkëpunimit.”



Goran Svilanović, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal

Pasqyrë e organizatës

Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (KBR) u themelua më 27 shkurt 2008, si trashëgimi e Paktit të Stabilitet për Evropën Juglindore. KBR-ja është krahu operativ i Procesit për Bashkëpunim të Evropës Juglindore (PBEJ) dhe funksionon si pikë kryesore për bashkëpunim në Evropën Juglindore (EJ) nëpërmjet një rrjeti të poseduar dhe drejtuar rajonalisht që gjithashtu mbështet integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik. Vepron si forum për përfshirjen e vazhdueshme të komunitetit ndërkombëtar që operon në rajon. Organizata inkurajon shtetet e EJ-së që më mirë të shfrytëzojnë mbështetjen e gatshme për bashkëpunim rajonal, kryesisht me anë të Instrumentit për Ndhimë Para-Hyrëse të BE-së (IPA), duke qenë pjesëmarrëse aktive në Grupet e Punës Strategjike për IPA.

- Detyra e KBR-së përqendrohet në fushat prioritare në vijim:
- zhvillim ekonomik dhe social
 - infrastrukturë dhe energji
 - drejtësi dhe punë të brendshme
 - bashkëpunim për siguri
 - ngritjen e kapitalit njerëzor dhe bashkëpunim parlamentar

Përveç kësaj, aktivitetet për zhvillimin e medieve të KBR-së, natyrisht duke u ndërlidhur, synojnë të kujdesen për zhvillimin e medieve të lira në EJ, duke marrë parasysh rolin e tyre në formimin e shoqërive demokratike, pluraliste dhe gjithëpërfshirëse në mbarë rajonin.

Dokumenti kryesor operativ që udhëheq punën e KBR-së është Strategjia dhe Programi i Punës 2011-2013, nënshkruar nga Samiti i PBEJ-së në qershor të vitit 2010 në Stamboll.

Anëtarësia e KBR përbëhet nga 46 shtete, organizata dhe institucione ndërkombëtare financiare Sekretariati i KBR-së ka selinë në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, e cila drejtohet nga



Sekretari i Përgjithshëm Goran Svilanović. Përveç zyrës qendrore në Sarajevë, Sekretariati ka një Zyrë Ndërlidhëse (Liaison) në Bruksel pranë institucioneve Evropiane dhe Euro-Atlantike.

Formati i mbledhjeve të KBR-së përbëhet nga Mbledhja Vjetore si dhe mbledhjet e Bordit të KBR-së, që mbahen çdo tremujor. Bordi i KBR-së siguron udhëheqje operative për organizatën. Përbëhet nga anëtarët e KBR-së që kontribuojnë për buxhetin e Sekretariatit të KBR-së si edhe nga Bashkimi Evropian (BE).

Zhvillimi ekonomik dhe social

KBR-ja promovon zhvillimin rajonal ekonomik dhe social në EJ duke koordinuar, lehtësuar dhe mbështetur iniciativat rajonale sociale dhe ekonomike dhe duke nxitur dialogun mes përpjekjeve rajonale reciprokisht të varura. Objektivat kryesore përfshijnë:

- përmirësimin e klimës investuese dhe ambientit për zhvillimin e bizneseve në EJ;
- përmirësimin e qasjes në financa për sektorin privat të rajonit;
- orientimin e punësimit dhe agjendave sociale si pjesë perberese e reformave ekonomike;
- promovimin e zhvillimit të shoqërisë së informacionit në Evropën Juglindore.

Për të arritur këto objektiva, Sekretariati i KBR-së krijon partneritete me një sërë organizatash, iniciativash dhe rrjetesh të rëndësishme rajonale. CEFTA 2006 ka themeluar nje zonë të tregtisë së lirë dhe

punon për ta thelluar ende më tepër. Komiteti për Investime në EJ (KIEJ) i menaxhuar nga KBR është forumi kryesor rajonal për të diskutuar reformat lidhur me investimet dhe përhapjen e analizës dhe këshillimit të politikave. Këshilli Afarist Këshillimor për Evropën Juglindore, si krahu i sektorit privat i KBR-së, ndihmon në artikullimin e zërit të sektorit privat në procesin e zhvillimit ekonomik në EJ. Iniciativa Elektronike e Evropës Juglindore (eSEE) mbështet zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit në rajon. Iniciativat dhe rrjete të tjera mbulojnë fushat e tregtisë, bujqësisë, promovimit të investimeve, partneritetet private-publike, sipërmarrjet e grave, punësimit dhe politikave sociale, sindikatës dhe shëndetit publik.



KBR-ja mbështet këto dhe iniciativat të tjera në përpjekje të përbashkëta për të zhvilluar ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese të tregut në EJ, të përforcuara me sisteme sociale të drejta dhe gjithëpërfshirëse.

Infrastrukturë dhe energji

KBR-ja fokusohet në energji dhe infrastrukturë si parakushte për zhvillimin e qëndrueshëm, stabilitetin dhe prosperitetin e përgjithshëm ekonomik, social dhe mjedisor. Ajo tenton të:

- mbështesë zbatimin e Traktatit themeltar të Komunitetit Energjetik;
- promovojë zhvillimin e energjisë së qëndrueshme në rajon dhe përcjellje të njohurive nga shtetet anëtare të BE-së për projekte të energjisë së qëndrueshme;
- kontribuojë për përgatitjen dhe zbatimin e Strategjisë për Rajonin e Danubit duke promovuar qasjen “nga poshtë-lartë”, duke bashkëpunuar me autoritetet lokale, shoqërinë civile dhe mediet;
- promovojë qasje multi-sektoriale për trajtimin e çështjeve të sigurisë së rrugëve;
- kontribuojë për zhvillimin e lidhjeve të trafikut ajror brenda rajonit;
- shqyrtojë potencialin për të mbështetur modalitetet e ndërmjetshme dhe operimin e infrastrukturës së transportit;
- mbështesë Procesin e Danubit për Bashkëpunim dhe Komisionin Ndërkombëtar të Pellgut të lumit Sava; gjithashtu të punojë me Qendrën Rajonale Mjedisore dhe të fokusohet në aktivitetet e Rrjetit Rajonal Mjedisor për Anëtarësim (RRMA).

Pjesëmarrja në Grupin Këshillimor të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare (IFN) i jep mundësi KBR-së që të shërbejë si një urë ndërmjetëse e mirëfilltë ndërmjet hartuesve të politikave, INF-ve, komunitetit të biznesit dhe partnerëve socialë. Si vëzhgues në Këshillin Drejtues të Kornizës Investuese për Ballkanin Perëndimor (KIBP), KBR-ja luan rol të rëndësishëm në identifikimin e projekteve të përshatshme për mbështetjen nga KIBP-ja dhe zbatimit të mëtejshëm.

Drejtimi dhe punë të brendshme

KBR-ja mbështet, promovon dhe koordinon veprimtarinë e iniciativave rajonale përkatëse të cilat janë aktive në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme në mbarë rajonin e EJ-së, duke siguruar njëkohësisht që përpjekjet e bëra të sjellin përförçim reciprok, të shmangin mbivendosjet dhe gjithashtu që ato të mbështesin e plotësojnë objektivat që rajoni ka për integrimin në BE. Objektivat strategjike përfshijnë:

- udhëzimin dhe vëzhgimin e bashkëpunimit rajonal nëpërmjet Dokumentit Strategjik Rajonal dhe Planit të Veprimit për Çështje Drejtësie dhe Punë të Brendshme 2011-2013 e cila ndjek një bashkëpunim rajonal të integruar, koherent dhe transparent, duke lehtësuar harmonizimin e aktiviteteve të donatorëve;



- lufta kundër krimit të organizuar - ekonomik dhe financiar, kontrabanda e drogave dhe trafikimi me qenie njerëzore. Vëmendje i jepet gjithashtu edhe dimensionit rajonal të kundër-terrorizmit. Roli kryesor luhet nga Qendra për Luftimin e Krimit Tej-Kufitar të Iniciativës për Bashkëpunim të Evropës Juglindore, Sekretariati i Konventës për Bashkëpunim Policor, Shoqata e Shefave Policorë të Evropës Juglindore, Grupi Këshillimor i Prokurorëve të Evropës Juglindore dhe Rrjeti i Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor me mbështetjen e KBR-së.
- lufta kundër korrupsionit, mbështetja e aktiviteteve të Iniciativës Rajonale kundër Korrupsionit;
- ngritja e kapacitetit të Iniciativës Rajonale për Migracion, Azil dhe Refugjatë;
- mbrojtja e të drejtave themelore si dhe bashkëpunimi në çështjet juridike private dhe civile, përfshirë edhe të drejtën për liri dhe siguri, qasje në drejtësi, të drejtë për gjykim të paanshëm dhe proces përkatës, ndihmë falas juridike, zgjidhje të kontesteve, mekanizma për ndihmë dhe rimëkëmbje të viktimave nga krimet.

KBR-ja bashkëpunon ngushtë me institucionet gjegjëse siç janë agjencitë e BE-së, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime, Këshilli i Evropës, INTERPOL-i dhe EUROPOL-i.

Bashkëpunim për siguri

Për të promovuar bashkëpunimin për siguri në Evropën Juglindore, KBR-ja ka marrë detyrë të:

- vendosë mekanizma të qëndrueshëm, të integruar, transparentë, dhe në pronësi rajonale mes institucioneve gjegjëse qeveritare;
- ruajë dhe orientojë iniciativat dhe grupe pune efektive që provojnë aftësinë e tyre të ofrojnë rezultate të dukshme në fushën e sigurisë;
- iniciojë aktivitete të reja me shpenzime të ulëta, me ndikim të fuqishëm mbi ngritjen e besimit dhe transparencës.

KBR-ja bashkëpunon me iniciativat rajonale që kanë zhvilluar projekte dhe mekanizma përkatëse për bashkëpunim sigurie. Anëtarësimi për secilën iniciativë përfshin disa shtete pjesëmarrëse në PBEJ-në si dhe shtete jashtë fushës së PBEJ-së, varësisht nga formati i iniciativës dhe rajonit të mbuluar.

KBR-ja ka identifikuar prioritetet në vijim për rajonin:

- përmirësimi i dialogut rajonal dhe mekanizmave për bashkëpunim për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes, përfshirë zhvillimin e strategjive të përbashkëta, planifikimin dhe koordinimin;

- zhvillimi i qasjes rajonale për uljen e rrezikut nga katastrofat me anë të pjesëmarrjes në programe të Komisionit Evropian për Uljen e Rrezikut nga Katastrofat dhe Mbrojtje Civile, zhvillimi i rrjeteve për luftën kundër zjarreve pyjore, ulja e përgjegjësisë fiskale për katastrofa natyrore dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal për trajtimin e materialeve të rrezikshme.

Ngritja e kapitalit njerëzor dhe bashkëpunimi parlamentar

Ngritja e kapitalit njerëzor është faktori themelor për konkurrencë afatgjate në Evropën Juglindore dhe integrim të suksesshëm në Evropë, në pajtim me objektivat e Strategjisë së Lisbonës dhe strategjisë Evropë 2020, dhe për këtë shkak KBR-ja:

- ndihmon projektin rajonal për Reforma Strukturore në Arsimin e Lartë. Vëmendje e posaçme dedikohet sigurimit të sinergjisë dhe shmangies së mbivendosjeve me programet arsimore të BE-së, integrimin të mëtejshëm me Fushën Evropiane të Arsimit të Lartë;
- kontribuon për zhvillimin e Strategjisë Rajonale për Hulumtim dhe Zhvillim për Inovacione të Ballkanit Perëndimor, të identifikojë kapacitetet ekzistuese për hulumtim dhe përmirësojë ndërlidhjet me instituteve dhe hulumtueseve të Ballkanit Perëndimor;
- koordinon fazën e re të Procesit të Lubjanës prej vitit 2011. Sektori i KBR-së për Kulturë dhe Shoqëri është themeluar me Sekretariatit në Çetinje, Mal të Zi, për të ndërmarrë udhëheqje të projekteve, aktivitete për ngritjen e financave dhe të veprojë si pala homologe për grupet e punës në nivel kombëtar.

Për arritjen e objektivave të caktuara, KBR-ja ka krijuar rrjetëzim mes shoqërisë civile dhe organizatave të rinjve, duke i përfshirë edhe ata në projektet e saj.

Bashkëpunimi parlamentar

KBR-ja ndihmon PBEJ-në gjatë zhvillimit të dimensionit parlamentar të punës së saj. Ndihmon në përgatitjen e mbledhjeve të Kryetarëve të Parlamentit të PBEJ-së, mbështet themelimin e rrjetit të koordinatorëve kombëtarë në nivel të Deputetëve dhe përkrah zbatimin e dokumenteve përkatëse. KBR-ja gjithashtu punon për zhvillimin e Forumit Parlamentar të Çetinjes në një qendër për koordinimin e përmirësuar të aktiviteteve parlamentare në Ballkanin Perëndimor lidhur me të drejtën Evropiane me anë të institucionalizimit dhe themelimit të një Sekretariati të qëndrueshëm.

